



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 1080/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelin e Shaban Skenderit, anëtar për Kuvendin Komunal në Dragash, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Dragash, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 16.11.2017, mori këtë:

#### V E N D I M

**REFUZOHET** si i pabazuar apeli i parashtruar nga Shaban Skenderi, anëtar për Kuvendin Komunal në Dragash, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Dragash, me shenjën ZL.Anr.1080/2017, të datës 16.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

#### A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 16.11.2017 ka pranuar apelin ZL.Anr.1080/2017 të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 10.11.2017, nga Shaban Skenderi, anëtar për Kuvendin Komunal në Dragash, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Dragash në të cilin pretendon se sipas rezultateve përfundimtare për asambleist në komunën e Dragashit nga KQZ-ja e kanë informuar se gjithsej i ka 176 vota, ndërsa sipas formularëve të KKZ-së në Dragash si dhe formularëve nëpër qendrat e votimit i ka 190 vota ku i njëjti pretendon se ka më pak 14 vota.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresave të lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Apeli është i pabazuar**

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se parashtruesi në apel me asnjë provë bindëse nuk i ka argumentuar me prova pretendimet e tij në apel. Prandaj, Paneli apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që

nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në mbështetje të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL.Anr.1080/2017 më datën 16.11.2017.



**Kryesues i Panelit**

Rafet Haxhaj

***Udhëzim Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*